



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 19/08/2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim nga OE GASHI EG SH.P.K.; EKO-DRINIA SH.P.K; të datës; 17/08/2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit, me numër identifikues: 613-21-9843-2-2-1, Nr i brendshëm 613 021 095 221., nxjerr këtë ;

### V E N D I M

I. Refuzohet: Kërkesa për Rishqyrtim e datës; 17.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit, me numër identifikues: 613-21-9843-2-2-1 Nr i brendshëm 613 021 095 221.

II. Vërtetohet: Mbetët në fuqi Vendimi për dhënie të kontratës së datës: 17.08.2022.

### A r s y e t i m


OE GASHI EG SH.P.K.; EKO-DRINIA SH.P.K; ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim më datë 17.08.2022, me të cilin ka kundërshtuar vendimin e AK, të datës; 17.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në Komunën e Lipjanit - Zona urbane e qytetit.

Autoriteti Kontraktues duke u bazuar edhe në vendimin e Bordit të Organit Shyrtues të Prokurimit me nr 45/22, të datës; 09.08.2022, ka vendosur që të vazhdoj me procedura të mëtutjeshme.

Autoriteti kontraktues vlerëson se qështja është e gjykuar (Res Judicata) dhe pala e pa kënaqur mund ti drejohet gjykatës kompetente sipas udhëzimit mbi këshillën juridike të vendimit Bordit të Organit Shyrtues të Prokurimit me nr 45/22, të datës; 09.08.2022,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Kundër këtij vendimi, ankuesi nuk ka të drejtë ankesë!

Bekim Shabani  
  
Drejtore i Prokurimit